



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

*Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor
dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre*

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K3/T8-9 Prot.

Tiranë 15/12/2022

Nr. Dok. 202101447/

Lënda: Rekomandim për përfundimin e shqyrtimit të procedurës së një aplikimi

DREJTORISË VENDORE TË AGJENCISË SHTETËRORE TË
KADASTRËS - TIRANA VERI

Rr. Rinasit

(pranë: "Tirana Biznes Park")

Tiranë

Për dijeni: - AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS

Rr. "Dora D'Istria"

Tiranë

- DREJTORISË VENDORE TË AGJENCISË SHTETËRORE TË
KADASTRËS - TIRANA JUG

Rr. Rinasit

(pranë: "Tirana Biznes Park")

Tiranë

- Znj. T.H (B)

Tiranë

Të nderuar,

Në vijim të korrespondencës sonë mbi hetimin administrativ të nisur nga Institucioni ynë për ankesën e shtetasës T.H (B), e cila ka paraqitur shqetësimin ndaj tejkalimit të afateve ligjore nga ana e DVASHK Tiranë, gjatë shqyrtimit të kërkesës së saj për legalizim e një shtese të ndodhur në truallin e saj, sjellim në vëmendjen tuaj sa vijon:

- Ankuesja T.H (B), i është drejtuar Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana – Veri (më poshtë DVASHK Tr. Veri) fillimisht në datë 24.12.2020.
- Duke mos patur asnjë përgjigje nga DVASHK Tr. Veri, në datë 04.11.2021 ankuesja i është drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, me kërkesë për të ndërhyrë për zgjidhjen e sa ajo ju kishte kërkuar.
- Pas ndërhyrjes së institucionit tonë (me shkresën nr. K3/T8-2 prot., datë 08.11.2021), nga ana e juaj (pra DVASHK Tr. Veri), jemi informuar se ju i keni kërkuar DVASHK Tr. Jug (me shkresën nr. 11266/1 prot., datë 16.11.2021), citojmë: *“...informimin e hollësishëm të subjektit mbi veprimet proceduriale të ndërmarra nga ana drejtorisë tuaj, pasi leja legalizimit nuk është emetuar nga ana drejtorisë tonë dhe praktika nuk administrohet pranë DVASHK Tiranë Veri”*.
- Duke qenë se nga DVASHK Tr. Jug nuk u krye asnjë veprim, me shkresën tonë nr. K3/T8-4 prot., datë 22.11.2021, i jemi drejtuar DVASHK Tr. Jug me kërkesën për informacion dhe dokumentacion.
- Në përgjigje të shkresën tonë të mësipërme, nga DVASHK Tr. Jug (me shkresën nr. 100051/1 prot., datë 22.11.2021), na u vu në dispozicion dokumentacioni përkatës, ndërsa ankueses ju kërkuar që të aplikonte nëpërmjet portalit E-albania.
- Pas sa më sipër, më datë 06.04.2022, nga ankuesja informohemi se:
 - a. Në datë 02.02.2022 ajo kishte përmbushur kërkesë e bërë nga DVASHK Tr. Jug, duke aplikuar nëpërmjet portalit E-albania,
 - b. Njëkohësisht ankuesja paraqiti pranë institucionit tonë shqetësimin, se ajo kërkesën e saj e kishte depozituar fillimisht pranë DVASHK Tirana Veri që në datë 24.12.2020 dhe se kjo duhej të merrej si datë fillestare e kërkesës së saj.

Në lidhje me këtë shqetësimin të ri të ankueses, në vlerësimin e institucionit tonë, si afat fillestar i kërkesës së saj, duhet marrë data kur ajo ka paraqitur kërkesën për herë të parë pranë institucionit tuaj. Konform legjislacionit në fuqi, ishte detyrim i institucionit tuaj të shqyrtonte kërkesën dhe në se kërkesa do gjykohej e paplotë, apo do kishte nevojë të kryheshin edhe veprime të tjera (psh nëse do ishte rasti të zbatohej pika 21 e VKM nr. 1178, datë 24.12.2020 sipas të cilës: *“Subjektet, që kanë bërë kërkesë për legalizim nga data 7.5.2020 deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi dhe për të cilat nuk është miratuar vendimi për legalizim, duhet të shlyejnë tarifën e aplikimit të parashikuar në pikën 12 të tij”*), duhej ti kthehej përgjigje ankueses për të bërë plotësimet përkatëse, por kurrësi nuk duhej lënë pa përgjigje.

- Për tu rikthyer në rastin e ankueses T.H (B), ajo i është drejtuar sërish institucionit tonë, duke na informuar se edhe pas aplikimit të saj nëpërmjet portalit E-albania të datës 02.02.2022, pas kalimit të afateve ligjore, i ishte drejtuar institucionit tuaj disa herë me kërkesa për informacion për ecurinë e praktikës së saj, duke ju bërë me dije se: *“afati i parashikuar nga aktet normative në fuqi për shqyrtimin e kërkesës së saj kishte përfunduar”, “ajo nuk kishte asnjë përgjigje dhe nga verifikimi i bërë në platformën E-albania, kërkesa e saj rezultonte me statusin: “Në procesim tek Shef Zone”*), por nuk ka pasur asnjë përgjigje.

- Pas sa më sipër me Rekomandimin tonë *“Për respektimin e afateve dhe procedurave që duhen ndjekur gjatë trajtimit të ankesave që lidhen me procedurat e legalizimit”*, (dërguar me tonën nr. K3/T8-8 prot., datë 13.05.2022), i jemi drejtuar DVAShK Tr. Jug duke e vënë në dijeni se, citojmë: *“... nga ana jonë vlerësohet i drejtë shqetësimi i ngritur nga ankuesja, për shkeljen e afateve ligjore, në rastin e trajtimit të kërkesës së saj”*.

Gjithashtu citojmë: *“Nisur edhe nga fakti që gjatë punës tonë, tashmë prej shumë vitesh po konstatojmë edhe shumë raste të tjera, të trajtimit të kërkesave të shtetasve për legalizime, në tejkallim të theksuar të afateve ligjore të sipërcituara, kërkojmë që jo vetëm për rastin e ankesës së shtetasës Tatjana Haxhimihali, por edhe për trajtimin e të gjitha ankesave për raste të tilla të ngjashme (pra që lidhen me procedurat e legalizimit)”*, kemi rekomanduar edhe:

1. Kryejën e një analize individuale, mbi shkakun e vonësve jo vetëm për rastin e ankesës së shtetasës Tatjana Haxhimihali, por edhe për trajtimin e të gjitha ankesave për raste të tilla të ngjashme (pra që lidhen me procedurat e legalizimit), si dhe evidentimin e personit/personave përgjegjës dhe propozimin e masës së përgjegjësisë në nivel hierarkik, sipas rastit.
2. Marrjen e masave për trajtimin e çdo kërkesë, brenda afateve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.
3. Marrjen e masave për respektimin e parashikimeve normative, në rast të ekzistencës së kushteve ligjore, për zgjatjen e afatit të trajtimit të ankesës, konform parashikimeve të nenit 92 të Kodit të Procedurave Administrative.”

- Pas Rekomandimit tonë të mësipërm, nga DVAShK Tr. Jug me shkresën nr. 10051/5 prot., datë 02.06.2022, jemi informuar se: Leja e legalizimit nr. 119534, datë 05.10.2017 në emër të ankueses, është lëshuar nga DVAShK Tr. Jug, por për sa i takon aplikimit për objektin shtesë që nuk është përfshirë në këtë leje legalizimi, bazuar në Urdhërin e drejtorit të përgjithshëm të ASHK nr. 470, datë 06.05.2019 *“Për përcaktimin e kompetencës së disa drejtorive të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës”*, është kompetencë e DVAShK Tr. Veri, ndaj institucionit tonë i kërkohej, citojmë: *“Mbi vijimin e procedurave administrative, lutemi ti drejtoheni Drejtorisë Vendore të ASHK-së Tiranë Veri”*.

- Përgjigjia e mësipërme në vlerësimin tonë ishte: a. *E pambështetur ligjërisht*; b. *E ndryshme nga qëndrimet e mbajtura nga DVAShK Tr. Jug në raste analoge*; c. Për më tepër *e ndryshme edhe nga praktika që vetë DVAShK Tr. Jug kishte ndjekur deri në atë moment*; sepse:

- a. Konform parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative dhe më konkretisht të nenit 24, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit: “1. Kur një organ publik merr një kërkesë, për një çështje që e vlerëson jashtë kompetencës të vet, ia përcjell kërkesën menjëherë, dhe në çdo rast jo më vonë se dy ditë nga marrja e saj, organit publik kompetent dhe njofton kërkuuesin për këtë...”, **do duhej që DVASHK Tr. Jug ti përcillte Drejtorisë Vendore të ASHK-së Tiranë Veri, të gjithë praktikën që lidhet me korrespondencën tonë, mbi hetimin administrativ pas ankimit të shtetases T.H (B),**
 - b. Në një rast analog, **DVASHK Tr. Jug i ka dërguar vetë për kompetencë DVASHK Tr. Veri, trajtimin e kërkesës përkatëse** (bashkëngjitur fotokopje e shkresës nr. 1726/prot., datë 03.11.2021, drejtuar për dijeni edhe institucionit tonë).
 - c. Kujtojmë se më sipër referuam se: pas ndërhyrjes së institucionit tonë (me shkresën nr. K3/T8-2 prot., datë 08.11.2021), nga ana e DVASHK Tr. Veri (me shkresën nr. 11266/1 prot., datë 16.11.2021), ju kërkuam DVASHK Tr. Jug, citojmë: “...informimin e hollësishëm të subjektit mbi veprimet proceduriale të ndërmarra nga ana drejtorisë tuaj, pasi leja legalizimit nuk është emetuar nga ana drejtorisë tonë dhe praktika nuk administrohet pranë DVASHK Tiranë Veri”, gjë kjo që nuk u kundërshtua nga DVASHK Tr. Jug, por përkundrazi u vazhdua të trajtohej nga vetë DVASHK Tr. Jug rasti (kujtojmë që DVASHK Tr. Jug -me shkresën nr. 100051/1 prot., datë 22.11.2021- na vuri në dispozicion dokumentacionin përkatës, ndërsa ankueses i kërkoi që të aplikonte nëpërmjet portalit E-albania).
- Në vijim të sa më sipër, me shkresën tonë nr. K3/T8-11 prot., datë 16.06.2022, i kemi kërkuar DVASHK Tr. Jug: “*Ti përcjellë Drejtorisë Vendore të ASHK-së Tiranë Veri, të gjithë praktikën që lidhet me shtetasen Tatjana Haxhimihali*”, si dhe “*Të na vinte në dispozicion edhe institucionit tonë një kopje të shkresës, me anë të të cilës do i përcillej DVASHK Tr. Veri, praktika që lidhet me rastin e shtetases T.H (B),*”.
 - Duke qenë se nga DVASHK Tr. Jug nuk patëm përgjigje brenda afateve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, i kemi rikujtuar me shkresën tonë nr. K3/T8-12 prot., datë 05.07.2022, për mungesën e përgjigjes.
 - Pas shkresës tonë të mësipërme, DVASHK Tr. Jug me shkresën nr. 4437/1 prot., datë 12.07.2022, jo vetëm nuk na ktheni përgjigje për sa kishim kërkuar me shkresat tona, por për më tepër na informoni se: “*pranë drejtorisë tonë nuk administrohet aplikim për legalizim për objektin shtesë në emër të zj. T.H (B),. Për këtë arsye orienton të aplikohet për kërkesën për legalizimin e ndërtimit pa leje në portalin E-Albania, që ky objekt ti nënshtrohet ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare ...” dhe akteve ligjore në fuqi.*”
 - Nga ana e institucionit tonë kjo përgjigje e DVASHK Tr. Jug, u konsiderua jo profesionale, kontradiktore, e pabazuar në ligj, në kundërshtimet me afatet ligjore, dhe si mungesë bashkëpunimi institucional.¹ Për sa më sipër, u ripërsërit kërkesa jonë (me shkresën tonë nr. K3/T1-7 prot., datë 02.08.2022), që: *Ti përcillej DVASHK Tr. Veri, e gjithë praktika që lidhet me shtetasen Tatjana Haxhimihali, si dhe të na vihej edhe ne në dispozicion një kopje e shkresës, me anë të të cilës do i përcillej DVASHK Tr. Veri, praktika që lidhet me rastin e shtetases T.H (B).*

¹ Për më tepër shih shkresën tonë nr. K3/T1-7 prot., datë 02.08.2022

- Vetëm pas shkresës tonë nr. K3/T1-7 prot., datë 02.08.2022, nga ana e DVAShK Tr. Jug, ju përcoll më datë 08.08.2022 e gjithë praktika DVAShK Tr. Veri.
- Ndërkohë më datë 24.08.2022 nga ana e DVAShK Tr. Veri, informohemi se, citojmë: *“Duke qenë se vetëdeklarimi është i vitit 2022, theksojmë se këto kërkesa do të trajtohen në një moment të dytë sipas planit të Drejtorisë sonë, pasi prioriteti jonë është trajtimi i vetëdeklarimeve të viteve 2005-2006...”*.

Në lidhje me këtë arsye të përdorur, pra për të mos trajtuar kërkesat e shtetasve brenda afateve ligjore, duke qenë se na ka rezultuar se është përdorur edhe më parë si arsye nga ana e DVAShK Tiranë në komunikime me të tjerë shtetas (bashkëngjitur fotokopje e shkresës së DVAShK Tr. Jug nr. 671/1 prot., datë 25.06.2019 drejtuar shtetasit G.T), do të ndalemi më hollësisht në shqyrtimin e saj, pasi **një arsye e tillë në vlerësimin tonë nuk ka mbështetje ligjore**. Siç edhe kemi parashtruar në Rekomandimin tonë “Për respektimin e afateve dhe procedurave që duhen ndjekur gjatë trajtimit të ankesave që lidhen me procedurat e legalizimit”, (dërguar me tonën nr. K3/T8-8 prot., datë 13.05.2022), ripërsërisim se:

- Në mungesë të një afati të posaçëm në legjislacionin që rregullon punën e institucionit tuaj, afati i përgjithshëm i parashikuar nga neni 91, pika 2 e Kodit të Procedurave Administrative, parashikon se, citojmë: *“2. Në mungesë të afateve të përcaktuara nga ligji i posaçëm, afati për përfundimin e procedurës administrative është 60 ditë”*. Gjithashtu neni 92 po i Kodit të Procedurave Administrative, parashikon se: *“1. Përveç kur ndalohet shprehimisht nga ligji, në raste të justifikuara, për shkak të kompleksitetit të çështjes, organi publik mund të zgjasë vetëm një herë afatin e përcaktuar sipas nenit 91 të këtij Kodi. 2. Zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar. 3. Zgjatja e afatit dhe data e përfundimit të afatit të zgjatur i njoftohen palës brenda afatit fillestar. Njoftimi duhet të përmbajë edhe arsyetimin për zgjatjen e afatit.”*

- Nga dokumentacioni përkatës i administruar deri më sot për këtë çështje (si ai i depozituar nga ankuesja, ashtu edhe ai i dërguar nga ana e DVAShK Tr. Jug dhe DVAShK Tr. Veri), nuk rezulton që të jetë bërë zgjatje e afateve të sipërcituara, ndaj nga ana jonë jo vetëm konstatohet tejkalimi i afateve, por vlerësohet i drejtë shqetësimi i ngritur nga ankuesja, për shkeljen e afateve ligjore, në rastin e trajtimit të kërkesës së saj.

Theksojmë se për sa kohë nuk ka akte normative, që të përcaktojnë afate të tjera për institucionin tuaj gjatë trajtimit të kërkesave të shtetasve, të vetmet afate ligjore që duhen zbatuar me përpikëri, janë ato të referuar më sipër.

Gjithashtu përfitojmë nga rasti t’ju informojmë se shkelje të afateve ligjore në trajtimin e kësaj praktike, na rezulton se ka jo vetëm në komunikimin ndërmjet DVAShK Tiranë me ankuesen T.H (B), por edhe në komunikimin që DVAShK Tirana Veri dhe DVAShK

Tirana Jug, kanë patur me institucionin e Avokatit të Popullit, për zgjidhjen e kësaj ankese. Kështu siç shpjeguar me hollësi më sipër, janë dashur mbi 10 (dhjetë) muaj dhe ndërhyrja e institucionit tonë, që DVAShK Tr. Veri dhe DVAShK Tr. Jug, të sqaroheshin ndërmjet tyre dhe përcjellë dokumentat përkatës. Ç'ka e bën edhe më të rëndë këtë situatë, është fakti që pas 10 muajsh, kur prisnim që pas sqarimit ndërmjet tyre të DVAShK Tirana Veri dhe DVAShK Tirana Jug, ti jepej zgjidhje ankësës së shtetasës T.H (B) në të kundërtën informohemi se kjo çështje lihet të trajtohet në një afat të pacaktuar.

Institucioni ynë përpaket të mirëkuptojë volumin e madh të rasteve që ka në trajtim Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe vlerëson punën që bëhet nga specialistët e këtij institucioni, por nga ana tjetër duke patur parasysh rëndësinë e zgjidhjes së problemeve të pronësisë (jo vetëm procesin e legalizimeve, por edhe atë të kthimit dhe kompensimit të pronave), si në raport me zhvillimin ekonomik të vendit, ashtu edhe të garantimit të të drejtës së pronësisë së shtetasve, ka rekomanduar edhe më parë ndërmarrjen e veprimeve konkrete, për shpejtimin e zgjidhjes së këtyre çështjeve.

Gjithashtu në informacionin e dhënë në fjalinë që cituam më sipër (që po e ripërsërisim: *“Duke qenë se vetëdeklarimi është i vitit 2022, theksojmë se këto kërkesa do të trajtohen në një moment të dytë sipas planit të Drejtorisë sonë, pasi prioriteti jonë është trajtimi i vetëdeklarimeve të viteve 2005-2006...”*), jo vetëm që siç argumentuam më sipër mungon mbështetja ligjore, por ka edhe disa parregullsia e problematika të tjera, si vijon:

- a. Bëhet referencë në një *“plan të Drejtorisë”*, por as nuk bashkëngjitet ky Plan dhe as nuk jepet ndonjë referencë e tij (psh data kur është miratuar, zyrtari që e ka miratuar, etj.).
- b. Për sa i përket datës së vetëdeklarimit të ankueses, konstatojmë se nga ana juaj nuk është përcaktuar saktë data se kur ka nisur kjo procedurë. Pra ndryshe nga sa thuhet nga ana juaj, citojmë: *“vetëdeklarimi është i vitit 2022”*, sikurse cituam që në fillim të këtij Rekomandimi, ankuesja T.H (B), i është drejtuar fillimisht Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana – Veri që në datë **24.12.2020**.
- c. Nisur nga informacioni që jepet më pas në fjalinë e mësipërme, citojmë: *“...prioriteti jonë është trajtimi i vetëdeklarimeve të viteve 2005-2006...”*, në një kohë kur siç përmendëm më sipër, këtë arsye ju e keni përdorur edhe dy vjet e gjysëm më parë (shih bashkëngjitur fotokopjen e shkresës së DVAShK Tr. Jug nr. 671/1 prot., datë 25.06.2019 drejtuar shtetasit G.T), **tregon për një problematikë jo të vogël, e cila për vetë rëndësinë që ka, mund të jetë objekt i një inspektimi të veçantë nga institucioni ynë.**

Përfitojmë nga rasti të kujtojmë se nga ana e DVAShK Tiranë (si Jug, ashtu edhe Veri), në komunikimin disavjeçar që institucioni ynë ka për çështjet e legalizimeve, nuk na është dhënë kurrë ndonjë e dhënë në lidhje me ndonjë propozim, apo përpjekje konkrete të bërë nga këto Drejtori Vendore, apo që ky shqetësim të jetë përcjellë pranë organeve drejtuese të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (që konform nenit 7 pika 3 të ligjit “Për kadastrën”, janë Këshilli Drejtues dhe drejtori i përgjithshëm).

Së fundi duam të sjellim në vëmendjen tuaj se siç kemi parashtruar në Rekomandimin tonë “Për respektimin e afateve dhe procedurave që duhen ndjekur gjatë trajtimit të ankesave që lidhen me procedurat e legalizimit”, (dërguar me tonën nr. K3/T8-8 prot., datë 13.05.2022), rezulton se nga dokumentacioni i administruar gjatë këtij hetimi administrativ (si nga dokumentat e sjella nga ankuesja, ashtu edhe nga shkresat tuaja nr. 10051/1 datë 22.11.2021 dhe 10051/3, datë 25.11.2021), ndërtimi për të cilin ankuesja ka bërë kërkesë për legalizim, ndodhet brenda pronës së saj, ç’ka në pamje të parë krijon përshtypjen se mund të plotësojë kriteret e parashikuara nga ligji 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, gjë që do të kërkonte më pak kohë për shqyrtimin e kësaj kërkesë.

Për tu rikthyer në analizën ligjore të rastit, të drejtat e shtetasve për të trajtuar çështjet e tyre: brenda afateve të parashikuara nga aktet normative në fuqi, në mënyrë të ligjshme, transparente, të paanshme, të drejtë, duke i ndihmuar ata në mënyrë aktive, apo edhe e drejta e tyre për tu informuar për veprimtarinë e organeve shtetërore (veçanërisht në rastet kur ata janë pjesëmarrës në procedura administrative), janë të drejta të parashikuara jo vetëm nga Kodi i Procedurave Administrative (nenet 4, 5, 6, 10, 13, 15, 18/2, etj.), por së pari nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Në vijim të sa më sipër, do të referonim edhe nenin 23, pika 2 të Kushtetutës, sipas të cilit: “2. *Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, ...*”, ndërkohë që sipas nenit 42 pika 1 po të Kushtetutës: “*Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor*”. Fakti që ankuesja, për shkaqe të pavarura nga ajo, nuk arrin të marrë një vendim përfundimtar në një procedurë administrative, në një kohë që ka respektuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni përkatës, bën që ajo të mos arrijë të gëzojë nga prona e saj, të drejtat që i garanton legjislacioni në fuqi.

Po kështu zgjatja e një procedure të tillë pa përcaktuar një afat fundor, parë në një këndvështrim më të gjerë, cënon edhe parimin e sigurisë juridike. Kjo për arsye se parimi i sigurisë juridike presupozon besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe jo vetëm pandryshueshmërinë e legjislacionit për marrëdhëniet e rregulluara, por edhe garantimin e ligjshmërisë së veprimeve që shteti kryen me qytetarët e tij, sigurinë juridike se qytetari është objekt i veprimeve të ligjshme dhe se institucionet shtetërore do i garantojnë të drejtat dhe liritë themelore të tij.

Shkelja e të drejtave të mësipërme, sjell në marrëdhënie me shtetasit një sërë problematikash, duke filluar që nga humbja e besimit të qytetarëve tek organet e administratës publike, e deri tek rreziku i përballjes së organeve të administratës me padi civile për dëm jashtëkontrator, që mund ti jetë shkaktuar shtetasve, nga shkelja e të drejtave të sipërpërmendura.

Ashtu sikurse kemi përmendur edhe në Rekomandimin tonë “Për respektimin e afateve dhe procedurave që duhen ndjekur gjatë trajtimit të ankesave që lidhen me procedurat e legalizimit”, (dërguar me tonën nr. K3/T8-8 prot., datë 13.05.2022), institucioni ynë vlerëson se vonesa në trajtimin e praktikës së shtetasës T.H (B), kufizojnë liritë dhe të drejtat e saj të garantuara nga Kushtetuta dhe ligji, e më konkretisht: *të drejtën e pronësisë*.

Nisur edhe nga fakti që gjatë punës tonë, tashmë prej shumë vitesh po konstatojmë edhe mjaft raste të tjera, të trajtimit të kërkesave të shtetasve për legalizime, në tejkalim të theksuar të afateve ligjore të sipërcituara, në mbështetje të nenit 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas të cilit: “3. Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike.....”, si dhe nenit 21 gërma b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” - i ndryshuar, sipas të cilit: “Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit kryen këto veprime:... b) paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”

REKOMANDOJMË

Marrjen e masave për përfundimin e shqyrtimit të aplikimit të shtetases T.H (B), brenda afateve të parashikuara nga neni 91, pika 2, të Kodit të Procedurave Administrative.²

Në zbatim të nenit 22, të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” – i ndryshuar, “Detyrimi i organeve të administratës për t’ju përgjigjur rekomandimeve të Avokatit të Popullit”, sipas të cilit: “**Organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, kërkesë apo propozim për shkarkim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin, kërkesën apo propozimin për shkarkim dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit, kërkesës apo propozimit për shkarkim. Përgjigjja duhet të përmbajë shpjegime të arsyetuara për çështjen në fjalë, si dhe çfarë veprimesh, mosveprimesh apo masash ka ndërmarrë ai organ. Avokati i Popullit duhet të njoftohet dhe ka të drejtë të marrë pjesë e të flasë në mbledhjet e organeve kolegjiale të administratës publike, ku merret në shqyrtim rekomandimi, kërkesa apo propozimi i tij**”, lutemi të na vini në dijeni mbi zbatimin e këtij Rekomandimi, brenda afatit ligjor të sipërcituar.

Duke ju falënderuar paraprakisht,

Në mungesë dhe me Urdhër

K O M I S I O N E R

Ahmet PRENÇI

d.v

² Kodi i Procedurave Administrative, neni 91: “2. Në mungesë të afateve të përcaktuara nga ligji i posaçëm, afati për përfundimin e procedurës administrative është 60 ditë”.